



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2023:193352

Datë: 12.03.2024

Numri i dokumentit: 05436558

**P.nr. 2023:193353**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal,** gjyqtari i vetëm gjykues Adem Shabani, me zytaren ligjore Arbelinda Tahiri, në lëndën penale kundër të pandehurve Xh.S., dhe L.S., që të dy me vendbanim në fshatin ..., Komuna Prizren, A.P., dhe M.P. që të dy me vendbanim në Fshatin ..., Komuna Shtime, dhe S.J., me vendbanim në Fshatin ..., Komuna Prizren, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/IL.nr.108/23, të datës 06.09.2023, secili veç e veç kanë kryer veprën penale Sulmi, nga neni 184 paragrafi 1 të KPRK-së, pas përfundimit të seancës së shqyrtimit fillestar të hapur për publikun, të mbajtur me datë 12.02.2024, në të cilin ish-in të pranishëm Prokurori i Shtetit Adrian Emini, të pandehurit, dhe mbrojtësi i të pandehurit L.S., me autorizim Av.Berlil Shashivari, të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 12.03.2024 përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Të pandehurit:**

**1. Xh.S.**, me vendbanim në fshatin ..., Komuna Prizren, e lindur me datën ..., nga i ati L., dhe nëna L., e gjinisë R., shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollen e mesme, profesinin transport rrugor, e martuar e gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal ....., mbrohet në liri,

**2. L.S.**, me vendbanim në fshatin ..., Komuna Prizren, i lindur me datën ..., nga i ati V. dhe nëna A., e gjinisë A., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën fillore, prind i katër fëmijëve i gjendjes së mesme ekonomike, me nr.personal ....., mbrohet në liri,-

**3. M.P.**, me vendbanim në Fshatin ..., Komuna Shtime, e lindur me datën ..., nga i ati B., dhe nëna N., e gjinisë R., shqiptare Kosovare, shtetase e Republikës së Kosovës, ka të

kryer shkollën e mesme, amvise, e martuar nënë e tre fëmijëve e gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal ..., mbrohet në liri,-

**4. S.J.**, me vendbanim në Fshatin ..., Komuna Prizren, i lindur me datën ..., nga i ati A. dhe nëna F., e gjinisë M., Kosovar, kombësia boshnjak, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën fillore, prindë i dy fëmijëve i gjendjes së mesme ekonomike, punon privat, me nr. personal ..., mbrohet në liri,-

## JANË FAJTORË

SEPSE:

### **E pandehura Xh.S.**

- Më datë 24.12.2022, rreth orës 10:00, në Shtime, në rrugën "...", saktësisht në oborrin e Qendrës për Punë Sociale, e pandehura me dashje përdor forcën ndaj të dëmtuarës/pandehurës M.P., në atë mënyrë që si rezultat i një mosmarrëveshje që kishin mes vete në lidhje me realizimin e kontaktit që kishte e pandehura me fëmijën e saj të mitur, e që ky kontakt duhet të realizohej pranë QPS-së, të njëjtat fillimisht fjalosen mes vete dhe më pas fillojnë ta sulmojnë njëra tjetrën, ku e pandehura e godet me shuplakë në fytyrë të dëmtuarën/pandehurën dhe më pas ndërhyjnë persona të tjerë dhe nuk lejojnë që të përleshën edhe më tutje mes vete dhe nga kjo goditje e dëmtuara/pandehura nuk kishte pësuar lëndime të dukshme trupore,-

**- me çka ka kryer veprën penale: Sulmi nga neni 184 paragrafi 1 të KPRK-së.**

### **E pandehura M.P.:**

- Më datë 24.12.2022, rreth orës 10:00, në Shtime, në rrugën "...", saktësisht në oborrin e Qendrës për Punë Sociale, e pandehura me dashje përdor forcën ndaj të dëmtuarës/pandehurës Xh.S., në atë mënyrë që si rezultat i një mosmarrëveshje që kishin mes vete në lidhje me realizimin e kontaktit që kishte e dëmtuara/pandehura me fëmijën e saj të mitur, e që ky kontakt duhet të realizohej pranë QPS-së, të njëjtat fillimisht fjalosen mes vete dhe më pas fillojnë ta sulmojnë njëra tjetrën, ku e pandehura e godet me telefon në ballë të dëmtuarën/pandehurën dhe më pas ndërhyjnë persona të tjerë dhe nuk lejojnë që të përleshën edhe më tutje mes vete dhe nga kjo goditje e dëmtuara/pandehura nuk kishte pësuar lëndime të dukshme trupore,-

**- me çka ka kryer veprën penale: Sulmi nga neni 184 paragrafi 1 të KPRK-së.**

### **I pandehuri L.S.:**

- Më datë 24.12.2022, rreth orës 10:00, në Shtime, në rrugën "...", saktësisht në oborrin e Qendrës për Punë Sociale, i pandehuri me dashje përdor forcën ndaj të dëmtuarit/pandehurit A.P., në atë mënyrë që si rezultat i një mosmarrëveshje që kishin mes vete në lidhje me realizimin e kontaktit që kishte e pandehura Xh.S. me fëmijën e saj të mitur, e që ky kontakt duhet të realizohej pranë QPS-së, të njëjtit fillimisht fjalosen mes vete dhe më pas fillojnë ta sulmojnë njëri tjetrin, ku i pandehuri e godet me grusht në fytyrë të dëmtuarin/pandehurin dhe më pas ndërhyjnë persona të tjerë dhe nuk lejojnë që të përleshën edhe më tutje mes vete dhe nga kjo goditje i dëmtuari/pandehuri nuk kishte pësuar lëndime të dukshme trupore,-

**- me çka ka kryer veprën penale: Sulmi nga neni 184 paragrafi 1 të KPRK-së.**

### **I pandehuri S.J.:**

- Më datë 24.12.2022, rreth orës 10:00, në Shtime, në rrugën "...", saktësisht në oborrin e Qendrës për Punë Sociale, e pandehura me dashje përdor forcën ndaj të dëmtuarit/pandehurit A.P., në atë mënyrë që si rezultat i një mosmarrëveshje që kishin mes vete në lidhje me realizimin e kontaktit që kishte e pandehura Xh.S. me fëmijën e saj të mitur, e që ky kontakt duhet të realizohej pranë QPS-së, të njëjtit fillimisht fjalosen mes vete dhe më pas i pandehuri me një mjet të mprehtë në dorë (brisk me patentë), mjet ky i rrezikshëm me të cilin mund të shkaktohet lëndim i rëndë trupor apo dëmtim i rëndë i shëndetit, i vërsulet të dëmtuarit për ta sulmuar por që aty ndërhyjnë bashkëshortja e të pandehurit dhe nuk e lejon që ta godas të dëmtuarin/pandehurin,-

**- me çka ka kryer veprën penale: Sulmi nga neni 184 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1, të KPRK-së.**

I. Gjykata në bazë dispozitës ligjore si më lartë dhe neneve 4 par. 1 nën-par. 1.4, 7, 17, 21, 31, 69, 70, 81, 82, si dhe neneve 364, 367, 449, 452 par. 1, 462, 498 dhe 499 të KPP-së, të pandehurve u:

## SH Q I P T O N V Ë R E J T J E G J Y Q Ë S O R E

Me këtë vërejtje gjyqësore të pandehurve Xh.S., L.S., M.P., dhe S.J., u bëhet me dije secilit veç e veç, kanë kryer vepra të dëmshme dhe të rrezikshme qe përbëjnë vepra penale, dhe nëse prapë kryejnë vepra të tilla gjykata të njëjtëve do ti u shqiptoi sanksionin me të rëndë penal.

Te pandehurit obligohen qe secili veç e veç që në emër të paushallit gjyqësore dhe shpenzimet e procedurës gjyqësore për hartimin e ekspertizë te paguaj shumen prej **25 ( njëzet**

**e pesë ) euro**, si dhe në emër të taksës për Kompensimin e Viktimave të Krimitshumën prej **20 ( njëzet ) euro** në afat prej 15 ditësh nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë.

**II.** Konform nenit 35 paragrafi 1 dhe 2 të KPP-së, (Kodit të Procedurës Penale Nr.08L-032) VEÇOHET procedura kundër të pandehurit, A.P., me vendbanim në Fshatin ..., Komuna Shtime, i akuzuar sipas aktakuzës së PP/II.nr.108/23, të datës 06.09.2023, për veprën penale Sulmi, nga neni 184 paragrafi 1 të KPRK-së, pasi që për veprën penale që akuzohet në pikën e IV të dispozitivit të aktakuzës në shqyrtimin fillestar nuk e ka pranuar fajësinë.

Obligohet Administrata e Gjykatës Themelore në Ferizaj- që të regjistroj me numër të veçantë lëndën penale sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP/II.nr.108/23, të datës 06.09.2023 për të akuzuarin A.P., me vendbanim në Fshatin ..., Komuna Shtime, i akuzuar se ka kryer Sulmi, nga neni 184 paragrafi 1 të KPRK-së.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm, në Gjykatën Themelore në Ferizaj ka parashtruar aktakuzën me numër PP/II.nr.108/23, të datës 06.09.2023 kundër të pandehurve Xh.S., dhe L.S., që të dy me vendbanim në fshatin ..., Komuna Prizren, A.P., dhe M.P. që të dy me vendbanim në Fshatin ... Komuna Shtime, dhe S.J., me vendbanim në Fshatin ..., Komuna Prizren, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.108/23, të datës 06.09.2023, secili veç e veç kanë kryer veprën penale Sulmi, nga neni 184 paragrafi 1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale, gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 12.02.2024, në të cilën pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit dhe pasi është bindur se të pandehurit kanë kuptuar aktakuzën, në kuptim të nenit 241 par. 4 të KPP-së, të njëjtëve u ka ofruar mundësinë e deklarimit rreth fajësisë - të pranojë fajësinë për veprën penale për të cilën janë akuzuar apo të deklarohen të pafajshëm.

E pandehura Xh.S., në seancën e shqyrtimit fillestar, me rastin e deklarimit të saj rreth fajësisë për veprën penale për të cilën është akuzuar, ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar, ka shprehur keqardhje për veprimet e saja me premtimin se në të ardhmen nuk do të përsëris veprën penale, nga gjykata kërkon që me rastin e caktimit të dënimit ti shqiptojë një dënim më të butë penale.

E pandehura M.P., në seancën e shqyrtimit fillestar, me rastin e deklarimit të saj rreth fajësisë për veprën penale për të cilën është akuzuar, ka pranuar fajësinë por nga ky rast më asnjëherë s’kemi pas probleme, është hera e parë bie ndesh me ligjin, i propozoj gjykatës që të

merr parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese me rastin e matjes së dënimit dhe ti shqiptojë një dënim më të butë penale.

I pandehuri L.S., në seancën e shqyrtimit fillestar, me rastin e deklarimit të tij rreth fajësisë për veprën penale për të cilën është akuzuar, ka deklaruar se pranoj fajësinë për veprën penale për të cilën me ngarkon aktakuza, ka ndodhur rasti, ka qenë moment i atëçastshëm nuk kam mundur ta kontrolloj veten, nga ky rast më nuk kam pas probleme.

I pandehuri S.J., në seancën e shqyrtimit fillestar, me rastin e deklarimit të tij rreth fajësisë për veprën penale për të cilën është akuzuar, ka deklaruar se pranoj fajësinë për veprën penale për të cilën me ngarkon aktakuza, jam penduar për atë që ka ndodhur, kërkoj falje për atë që ka ndodhur, premtoj se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla apo të ngjashme penale.

I pandehuri A.P., në seancën e shqyrtimit fillestar, me rastin e deklarimit të tij rreth fajësisë për veprën penale për të cilën është akuzuar, ka deklaruar se nuk e pranoj fajësinë për veprën penale për të cilën me ngarkon aktakuza.

Pas pranimit të fajësisë nga të pandehurit Xh.S., L.S., M.P., dhe S.J., Gjykata në kuptim të nenit 242 par.5 të KPP-së, ( Kodi i Procedurës Penale Nr.08/L-032), për vlerësimin e pranimit të fajësisë së të pandehurve, ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit dhe mbrojtësi i të pandehurit L.S., Av. Berhil Shashivari. lidhur me pranimin e fajësisë nga të pandehurit për veprat penale që akuzohet.

Prokurori i Shtetit Ardian Emini lidhur me pranimin e fajësisë për veprat penale që akuzohen të pandehurit sipas dispozitivave të aktakuzës nuk e kundërshtoj pranimin e fajësisë nga të pandehuri, ky pranim është bërë vullnetarisht pa presion dhe të vetëdijshëm për pasojat e pranimit kjo ka mbështetje edhe në provat tjera materiale të lëndës, si dhe në përputhje me dispozitat e nenit 242 të KPPK-së, kërkojmë nga gjykata që të njëjtit ta shpallë fajtores dhe ta dënojë konform ligjit duke pas parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese dhe me sanksionin e shqiptuar të arrihet qëllimi i dënimit.

Mbrojtësi i të pandehurit L.S. av. Berhil Shashivari, pas konsultimit të mjaftueshëm me të pandehurin, i cili ka kuptuar pasojat dhe pranimin e fajësisë si dhe bene fitet e pranimit e fajësisë në këtë fazë të procedurës, i njëjti me vullnet pa presion dhe me vetëdije të plot pranon fajësinë, propozoj Gjykatës që bëjë pranimin e fajësisë dhe gjatë shqyrtimit të dënimit të merr si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë.

Gjykata ka fituar bindjen se të pandehurit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë për veprën penale, që i vihet në barrë, dhe është bindur se pranimin e kanë bërë në baza vullnetare, pas sqarimeve të mjaftueshme nga ana Gjykatës për pasojat dhe favore të pranimi të fajësisë si dhe duke u mbështetur edhe në faktet dhe provat që i përmban Aktakuza, Deklarata e të pandehurës Xh.S., të dhënë në Stacionin Policor në Shtime, më datë 24.12.2022; Deklarata e të pandehurit L.S., të dhënë në Stacionin Policor në Shtime, më datë 24.12.2022; Deklarata e të pandehurës M.P., të dhënë në Stacionin Policor në Shtime, më datë 24.12.2022; Deklarata e të pandehurit S.J., të dhënë në Stacionin Policor në Shtime, më datë 24.12.2022; Deklarata e të pandehurit A.P., të dhënë në Stacionin Policor në Shtime, më datë 24.12.2022; Raporti mjekësor të lëshuar nga QKMF “Dr. V.B.” në Shtime, me numër protokollit: Nr... të datës 24.12.2022; Raportet mjekësore të lëshuar nga QKMF “Dr. V.B.” në Shtime, me numër protokollit: Nr. ... të datës 24.12.2022; Raportet mjekësore të lëshuar nga QKMF “Dr. V.B.” në Shtime, me numër protokollit: Nr. ... të datës 24.12.2022; Raportet mjekësore të lëshuar nga QKMF “Dr. V.B.” në Shtime, me numër protokollit: Nr. ... të datës 24.12.2022; Dy vërtetime mbi konfiskimin e sendeve të datës 24.12.2022; Akt-ekspertiza mjeko-ligjore e përpiluar nga Dr. N.U., e dt. 17.06.2023; Fotot e bëra në vendin e ngjarjes dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabime faktike.

Duke pas parasysh se gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve dhe ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 248 par. 1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPP-së, ( Kodi i Procedurës Penale Nr.08/L-032), si dhe faktin se janë plotësuar kushte nga neni 332 par. 4, të KPP-së, ( Kodi i Procedurës Penale Nr.08/L-032), atëherë në këtë çështje penale nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata pas deklarimit të pandehurit se e pranon fajësinë në kuptim të nenit 242 par. 2 të KPP-së, ( Kodi i Procedurës Penale Nr.08/L-032), andaj konform nenit 242 par. 6 të KPPRK-së vazhdoi me shqiptimin e dënimit.

- *Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurës Xh.S. manifestohen të gjitha elementet e veprave penale Sulmi nga neni 184 paragrafi 1 të KPRK-së.*

- *Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurës M.P. manifestohen të gjitha elementet e veprave penale Sulmi nga neni 184 paragrafi 1 të KPRK-së.*

- *Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit L.S. manifestohen të gjitha elementet e veprave penale Sulmi nga neni 184 paragrafi 1 të KPRK-së.*

- Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit S.J. manifestohen të gjitha elementet e veprave penale Sulmi nga neni 184 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.

Gjykata nuk gjeti rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të pandehurve dhe të njëjtit janë penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 69 par.1 dhe 70 të KPRK-së. Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurit, gjykata mori sjelljen korrekte në gjykatë, pranimin e fajësisë, sinqeritetin deklarues, pendimin për veprën e kryer, si dhe faktin se te pandehurit me pare nuk kanë qene të dënuar për ndonjë vepër tjetër penale dhe ndaj tyre nuk udhëhiqet ndonjë procedurë tjetër penale, ndërsa rrethana rënduese ndaj të pandehurit gjykata nuk gjeti. Sipas bindjes së gjyqtarit, vërejtja gjyqësore e shqiptuar, duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është vendim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurve. Gjyqtari i vetëm gjykues, gjithashtu ka konstatuar se me këto dënime mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 38 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale- paushallit gjyqësor dhe taksën për Programin për Kompensimin e Viktimave të Krimit është marrë në bazë të nenit 449 par. 2 pika 2.6 dhe 2.9 të KPP-së.

Gjykata me datën 12.02.2024, ka mbajtur shqyrtimin fillestar në këtë çështje penale ku të pandehurit Xh.S., M.P. L.S., dhe S.J., secili veç e veç kanë kryer veprën penale Sulmi, nga neni 184 paragrafi 1 të KPRK-së ku kanë pranuar fajësinë për veprat penale që akuzohen dhe të njëjtit janë shpallë fajtor.

I pandehuri A.P., me vendbanim në Fshatin ..., Komuna Shtime, për veprën penale që akuzohet i akuzuar sipas aktakuzës së PP/II.nr.108/23, të datës 06.09.2023, për veprën penale Sulmi, nga neni 184 paragrafi 1 të KPRK-së, në pikën e IV të dispozitibit të aktakuzës në shqyrtimin fillestar nuk e ka pranuar fajësinë, Gjykata për shkak të rëndësisë dhe të efikasitetit pasi që te pandehurit e lartë cekur veç e veç kanë pranuar fajësinë për verat penale që

akuzohen dhe janë shpallur fajtor kurse i pandehuri A.P. , që nuk e ka pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar, Gjykata, konform nenit 35 paragrafi 1 dhe 2 të KPP-së ka bërë veçimin e procedurës penale për te dhe në vazhdim Gjyqtari i vetëm gjykues e njofton të pandehurin A.P. që brenda afatit jo më vonë se prej 30 ditëve të paraqesin kundërshtimet e tyre për provat e cekura në aktakuzë, të paraqesin kërkesat për hudhjen e aktakuzës, të cilat i parasheh ligji, të paraqesin kërkesat për hudhjen e aktakuzës për shkak të mos përshkrimit të veprës penale sipas ligjit.

Nga arsyet e cekura më lartë është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
Departamenti i përgjithshëm-divizioni penal,  
**P.nr. 2023:193353, me datë 12.03.2024**

**Zyrtare ligjore**  
Arbelinda Tahiri

**Gjyqtari**  
Adem Shabani

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.